



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2025/0883

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga U.D Kryetari i Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Vedat Poterqoi - Kryetar, duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) “Inspired Tech” SH.P.K., kundër Vendimin për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit të “MINISTRIA E SHËNDETËSISË” në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit “Zhvillimi dhe avancimi i sistemit informativ të QKKTGJ” me numër të prokurimit 206-25-4780-2-1-1, me 20/10/2025, mori:

Vendim

1. Aprovohet, si pjesërisht e bazuar ankesa e OE “Inspired Tech” SH.P.K. me nr. 2025/0883, e datës 10/09/2025, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Zhvillimi dhe avancimi i sistemit informativ të QKKTGJ” me numër të prokurimit 206-25-4780-2-1-1

2. Anulohet B58 Njoftimi mbi Vendimin e AK të “MINISTRIA E SHËNDETËSISË”, ndërkaq aktiviteti i prokurimit “Zhvillimi dhe avancimi i sistemit informativ të QKKTGJ” me numër të prokurimit 206-25-4780-2-1-1 kthehet në **Rivlerësim**.

3. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarrë masa ndaj AK për mos respektim të vendimit sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të LPP.

4. Kthehen mjetet e deponuara në emër të taksës tarifore për parashtrimin e ankesës në llogarinë e Operatorit Ekonomik “Inspired Tech” SH.P.K. OE ankues obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 29.05.2025, “MINISTRIA E SHËNDETËSISË” në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar B05 Njoftim për kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit me “Zhvillimi dhe avancimi i sistemit informativ të QKKTGJ” me nr. të prokurimit: 206-25-4780-2-1-1. Ndërsa me datën 26.08.2025 Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues për dhënie.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedura t? hapur, lloji i kontratës: SHËRBIM, vlera e parashikuar e kontratës: 168.000.00 €.

Me 28.08.2025, OE “Inspired Tech” SH.P.K ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. E cila me vendimin e AK me datën 02.09.2025 është refuzuar si te pa bazuar Kërkesën për Rishqyrtim.

Me 10/09/2025, OSHP ka pranuar ankesën nga OE “Inspired Tech” SH.P.K., me nr. 2025/0883 për lidhur me aktivitetin “Zhvillimi dhe avancimi i sistemit informativ të QKKTGJ” me nr. të prokurimit: 206-25-4780-2-1-1.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

OSHP ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë OSHP ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues “Inspired Tech” SH.P.K janë parashtruar si në vijim:

Autoriteti Kontraktues – Ministria e Shëndetësisë ka inicuar aktivitetin e prokurimit me titull: “Zhvillimi dhe avancimi i sistemit informativ të QKKTGJ”, me vlerë të parashikuar 168,000.00 €. Numri i prokurimit: 206-25-4780-2-1-1.

Ne, Operatori Ekonomik Inspired Tech SH.P.K., kemi ofertuar në këtë aktivitet me vlerë 57,400.00 €.

Me datën 26.08.2025, Autoriteti Kontraktues ka publikuar Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues, me anë të së cilit jemi njoftuar se oferta jonë është eliminuar si e papërgjegjshme, me këtë arsyetim:

“Nuk i keni plotësuar kriteret që janë kërkuar në NJK dhe DT. Tenderi juaj është refuzuar për këto arsye:

Tek kapaciteti teknik dhe profesional: Kërkesa 1. Kërkesa duhet të dëshmojë se ka realizuar me sukses projekte në dizajnimin, zhvillimin dhe implementimin në platformën Microsoft (.NET me SQL Server) në vlerën e përgjithshme të projekteve minimum 250,000.00 € në tri vitet e fundit duke filluar nga data e publikimit të njoftimit për kontratë. Së paku njëri nga projektet duhet të jetë në vlerën minimum 150,000.00 €. Është dorëzuar referencë për projektin i cili është ende i papërfunduar dhe si i tillë nuk e plotëson kriterin siç është kërkuar në DT.

Brenda afatit ligjor, ne si ofertues dhe palë me interes në këtë procedurë kemi paraqitur kërkesë për rishqyrtim pranë Autoritetit Kontraktues. Kjo kërkesë është refuzuar si e pabazuar. Pas këtij refuzimi,

jemi të detyruar t'i drejtohem organit tuaj me të njëjtin pretendim ankimor siç e kemi parashtruar pranë AK-së.

Rreth argumentit të AK-së se:

“Referenca e ofruar nga ana juaj në platformën Alleta për Sunny Hill-Tech, e ka statusin:

Projekti është aktualisht në vazhdim, me zhvillim dhe përsosje të zhdeshme”,

Lidhur me këtë, konsiderojmë se AK do të duhej të vepronte në përputhje me pikën 1 dhe 2 të nenit 72 të Ligjit për Prokurimin Publik, sipas të cilit përcaktohet me sa vijon:

1.Kur informacioni apo dokumentacioni që duhet të dorëzohet nga operatorët ekonomikë është ose duket të jetë jo i plotë ose i gabuar, ose kur mungojnë dokumente specifike, autoritetet kontraktuese mund të kërkojnë nga operatorët ekonomikë që të dorëzojnë, plotësojnë, sqarojnë apo kompletojnë informacionin apo dokumentacionin e duhur brenda një afati të caktuar kohor, me kusht që kërkesat e tilla bëhen në përputhje të plotë me parimet e trajtimit të barabartë dhe transparencës.

2.Autoriteti kontraktues mund të ftojë operatorët ekonomikë për të plotësuar apo qartësuar certifikatat dhe dokumentet e paraqitura në pajtim me nenet 65–71 të këtij ligji.

Në rastin konkret, AK ka vepruar në kundërshtim me këto dispozita, pasi që nuk ka ofruar mundësinë ofrimit të sqarimeve nga ne si Operator ekonomik. Në rast se AK do të vepronte sipas këtij neni, do të ofroheshin të gjitha sqarimet e nevojshme dhe do të kompletohej informacioni i plotë rreth referencës së dorëzuar. Në përmbushje të kërkesës 1 për kapacitetin teknik dhe profesional, ne si OE kemi dorëzuar referencën e mëposhtme:

Projekti Alleta 1.0

3.Vlera: 255,611.76 € (mbi pragun e kërkuar).

4.Teknologjia: .NET 7 SQL Server (përputhet me kërkesën teknike).

5.Periudha: 2023–2024 (brenda afatit 3-vjeçar).

6.Dokumentacioni: Referencë e lëshuar nga klienti dhe dëshmi për pagesat e kryera. Sipas dokumentit të bashkangjitur në ofertën tonë, dëshmohet se që nga nënshkrimi i kontratës për projektin Alleta 1.0, kemi pranuar pagesa në vlerë prej 255,611.76 €, gjë që vërteton përfundimin e projektit sipas fazave të planifikuara. Pagesa nga autoriteti kontraktues, me të cilin kemi pasur kontratë, përbën dëshmi dhe provë kryesore për punën e kryer.

Prandaj, nuk qëndron konstatimi mbi të cilin është refuzuar oferta jone, për shkak se projekti nuk ka përfunduar. Pavarësisht periudhës së zhvillimit të platformës, modulet e zhvilluara janë paguar dhe përfunduar në tërësi. Sipas legjislacionit aktual, nuk ekziston ndonjë përkufizim ose kriter i detyrueshëm që specifikon se kur një projekt konsiderohet i përfunduar. Kur autoriteti kontraktues ka kryer pagesën për një modul të zhvilluar, kjo tregon qartë se puna e realizuar është e plotë, pasi fatura dhe pagesa përbëjnë prova të pakontestueshme të punës së kryer.

Tutje, nga AK thuhet:

“Kjo referencë do ishte e pranueshme sikur aktiviteti të ishte për mirëmbajtje, meqenëse te mirëmbajtja pranohet shërbimi i kryer për periudha të caktuara, ndërsa te aktivitetet si ky që është për dizajnimin, zhvillimin dhe implementimin kemi të bëjmë me një projekt si tërësi kur dizajnohet apo zhvillohet si platformë, andaj nuk merret parasysh projekti në vazhdim – që nuk është përfunduar.”

Rreth këtij argumenti, konsiderojmë se sërish AK do të duhej të vepronte në përputhje me pikat 1 dhe 2 të nenit 72 të Ligjit të Prokurimit Publik.

Mbi këtë bazë, sqarojmë se fazat e përfunduara të projektit përfaqësojnë rezultate të qarta, të matshme dhe funksionale në aspektin e dizajnit, zhvillimit dhe implementimit. Këto faza dëshmojnë në mënyrë të verifikueshme kapacitetin profesional dhe përvojën tonë praktike në realizimin e aktiviteteve të kërkuara. Për këtë arsye, konsiderojmë se referenca është e vlefshme dhe duhet të pranohet si provë e aftësisë sonë për realizimin e kontratës.

Duke u referuar pretendimeve si më sipër “TSR” SH.P.K., konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me Neni 6 – Ekonomiciteti dhe Efikasiteti, Neni 7 i LPP – Barazia në Trajtim / Jo-Diskriminimi, Neni 59 – Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve, Neni 68 – Gjendja Ekonomike dhe Financiare, Neni 69 – Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale, Neni 72 – Dokumentacioni dhe Informacioni shtesë. Prandaj, duke u mbështetur në të gjitha faktet dhe argumentet e paraqitura më sipër, me respekt i kërkojmë Organit Shqyrtues të Prokurimit që, pas shqyrtimit të plotë të pretendimeve tona ankimore, të nxjerr këtë vendim: 1. Pranohet në tërësi si e bazuar ankesa e Operatorit Ekonomik 2. Anullohet njoftimi mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues 3. Lënda kthehet në rivlerësim, në përputhje me dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik.

Përgjigje në kërkesën për Rishqyrtim: Përgjigjet e AK në lidhje me pretendimet ankimore të OE Inspired Tech SH.P.K. E kemi shqyrtuar kërkesën tuaj për rishqyrtim dhe mund të konstatojmë se pretendimi juaj ankimor është i pa bazuar për arsye se kërkesa e Tenderit ka qenë për projekte të realizuara:

Kërkesa 1. OF duhet të dëshmojë se ka realizuar me sukses projekte në dizajnimin, zhvillimin dhe implementimin në platformën Microsoft (NET me SQL Server) në vlerën e përgjithshme të projekteve minimum 250,000.00 – në tri vitet e fundit duke filluar nga data e publikimit të Njoftimit për kontratë. Se paku njeri nga projektet duhet të jetë në vlerën minimum 150,000.00 € Referenca e ofruar nga ana juaj në platformën Alleta për Sunny Hill-Tech, e ka statusin: Projekti është aktualisht në vazhdim, me zhvillim dhe përsosje të vazhdueshme. e Current Status: The project is currently ongoing, with continuous development and refinement. Kjo referencë do ishte e pranueshme sikur aktiviteti të ishte për mirëmbajtje, meqenëse te mirëmbajtja pranohet shërbimi i kryer për periudha të caktuara, ndërsa te aktivitetet si ky që është për dizajnimin, zhvillimin dhe implementimin kemi të bëjmë me një projekt si tërësi kur dizajnohet apo zhvillohet si platforme, andaj nuk merret parasysh projekti në vazhdim - që nuk është përfunduar. Përgjigjet e AK në lidhje me pretendimet ankimore të OE CMD SH.P.K. E kemi shqyrtuar kërkesën tuaj për rishqyrtim dhe mund të konstatojmë se pretendimi juaj ankimor është i pa bazuar për arsye se kërkesa e Tenderit ka qenë për projekte të realizuara: Kërkesa 1. OF duhet të dëshmojë se ka realizuar me sukses projekte në dizajnimin, zhvillimin dhe implementimin në platformën Microsoft (NET me SQL Server) në vlerën e përgjithshme të projekteve minimum 250,000.00 – në tri vitet e fundit duke filluar nga data e publikimit të Njoftimit për kontratë. Se paku njeri nga projektet duhet të jetë në vlerën min. 150,000.00 €. 10/12 Dëshmia b. Kur shërbimi është bërë për një blerës privat, kopja e çdo dokumenti të nënshkruar nga blerësi dhe evidentimi i realizimit të tillë. Në ofertën e juaj ju e keni

prezantuar një liste me 14 projekte dhe 6 referenca. Përveç referencës së AQP-së në vlerë 3,999.00 euro dhe Referencës nga Kolegji Biznesi në vlerë 36,000.00 euro, asnjëra reference tjetër nuk e ka të specifikuar vlerën e projektit. Për AK këto projekte të listuar nuk janë bindëse duke marrë parasysh se kriteri i tenderit ka qene i përshkruar në mënyrë specifike, janë kërkuar projekte të realizuara në tri vitet e fundit, në platformën Microsoft (.NET me SQL Server) në vlerën e përgjithshme të projekteve minimum 250,000.00 – (Se paku njëri nga projektet në vlerën min. 150,000.00 –). Te dëshmia e kërkuar e kriterit, është mundësuar që për blerës privat, të dëshmohet me çfarëdo dokumenti nga blerësi që janë kryer projektet siç është kërkuar - evidentimi i realizimit të tillë, ndërsa vetëm referenca për projektin nr. 6 - Waldemar APP në vlerë 34,020.00 – është me të dhënat rreth teknologjive të përdorura por pa vlerë të projektit. Oferta e juaj financiare është shumë me e lire se sa oferta e OE të rekomanduar dhe oferta juaj do të ishte shumë e favorshme financiarisht për AK për këtë arsye edhe kemi kërkuar sqarime shtese gjatë vlerësimit, me ç'rast u nuk keni arritur ta bindni AK për plotësimin e kriterit për projektet e kryera. Vlen të theksohet se Vlera e parashikuar në këtë tender ka qene 168,000.00 –, ndërsa ju keni ofertuar në vlerën 39,999.93 –, që është çmim jo normalisht i Ulet, por për shkak të mangësive të cekura në referenca në nuk e kemi trajtuar këtë pikë gjatë vlerësimit fillestar. Referuar UDHEZUES NR. 002/2024, PER PLOTESIM NDRYSHIMIN E UDHEZUESIT NR. 001/2023 PER PROKURIMIN PUBLIK, neni 11. Tenderët Jo-normalisht të Ulët, oferta juaj i plotëson të tre kushtet e parapara për tu trajtuar si oferte Jo normalisht e Ulet. Shembulli nga UDHEZUESI NR. 002/2024.

Ofertat e përgjegjshme:

Në bazë të sqarimeve të lartcekura, në si AK-MSh nuk kemi diskriminuar apo favorizuar asnjë OE, por sipas kriterëve të kërkuara në NJK dhe DT e kemi përzgjedhur ofertën e përgjegjshme me çmimin me të Lire e cila i ka plotësuar të gjitha kriteret dhe ka dëshmuar përvojën e kërkuar paraprake siç është kërkuar.

Duke u mbështetur në neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Organi Shqyrtues i Prokurimit me datë 12.09.2025 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 0883/2025, ndërsa me datë 17.09.2025 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 0883/2025 me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK nuk pajtohet rreth rekomandimeve të raportit të ekspertit shqyrtues, ndërsa OE nuk ka dhënë përgjigje rreth raportit të ekspertit shqyrtues.

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 paragrafi 1 të Rregullores së Punës së OSHP-së duke marrë parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtrësit e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritues lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtrësit dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE “Inspired Tech” SH.P.K ekspertit shqyrtues përmes raportit nr. 2025/0883 ka vlerësuar si në vijim:

Përshkrimi i ankesës

Ankesa është parashtruar nga Operatori Ekonomik “ Kompania e ‘Inspired Tech SH.P.K.” kundër MINISTRIA E SHËNDETËSISË për procedurën e prokurimit për “Zhvillimi dhe avancimi i sistemit informativ të QKKTGJ”. Ankuesi pretendon se është eliminuar padrejtësisht nga gara dhe kundërshtojnë shpalljen e operatorit fitues, duke theksuar ne si OE ankues i plotëson kushtet e kërkuara ne dosjen e tenderit te kriteri 9.1&9.2.

Kërkesa 1. OE duhet të dëshmoj se ka realizuar të paktën një projekt në dizajnimin, zhvillimin dhe implementimin në platformën Microsoft (.NET me SQL Server) në vlerë minimum 250,000.00 € në tri vitet e fundit duke filluar nga data e publikimit të Njoftimit për kontratë.

Dëshmia Një listë të kontratave të realizuara, ku duhet saktësuar titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën e fillimit dhe datën e përfundimit, si dhe listës t’i bashkëngjiten referencat ose certifikatat për shërbimet e kryera (të përfunduara). a. Kur shërbimi është bërë për një autoritet publik në Kosovë ose në një vend tjetër, për dëshmi duhet te dorëzohet referenca të lëshuara nga autoriteti i tillë; b. Kur shërbimi është bërë për një blerës privat, kopja e çdo dokumenti të nënshkruar nga blerësi dhe evidentimi i realizimit të tillë.

Kompania ankuese po ashtu theksojnë se kanë ofruar një çmim më të ulët si kompani e rekomanduar dhe sipas ankuesit i plotësojmë referencat e paraqitur ne oferte, e ne këtë ankesë pretendon se AK-ja nuk ka bere vlerësim te drejt ne përputhje me nenin 59 dhe 72 te LPP-se dhe duhet te kthehet lënda ne rivlerësim.

Pretendimi 1

Brenda afatit ligjor, ne si ofertues dhe palë me interes në këtë procedurë kemi paraqitur kërkesë për rishqyrtim pranë Autoritetit Kontraktues. Kjo kërkesë është refuzuar si e pabazuar. Pas këtij refuzimi, jemi të detyruar t’i drejtohem organit tuaj me të njëjtin pretendim ankimor siç e kemi parashtruar pranë AK-së.

Rreth argumentit të AK-së se:

“Referenca e ofruar nga ana juaj në platformën Alleta për Sunny Hill-Tech, e ka statusin:

Projekti është aktualisht në vazhdim, me zhvillim dhe përsosje të vazhdueshme”,

Lidhur me këtë, konsiderojmë se AK do të duhej të vepronte në përputhje me pikën 1 dhe 2 të nenit 72 të Ligjit për Prokurimin Publik, sipas të cilit përcaktohet me sa vijon

Përgjigjja ne pretendime 1

Eksperti shqyrtues ka analizuar dosjen e tenderit lidhur me kriterin qe është thirrur OE ankues ne kriterin e kërkuar DT, ku ceket se OE duhet te kenë dëshmi se ka përfunduar me sukses një projekt sipas aktivitetit te prokurimit ne vlere 250.000.00€. Ne këtë rast OE “Inspired Tech SH.P.K.” ankues ka dorëzuar listën e referencave për shërbimet qe janë kërkuar ne këtë aktivitet te prokurimit, ne listën e referencave qe është dorëzuar me oferte si ekspert shqyrtues konstatoj se OE ankues e ka te lëshuar

referencën nga Alletta Sales Platform AG dhe pagesat. Kjo reference është për periudhë 2023-2024 që se bashku me referencë janë lëshuar edhe pagesat në vlerë 255.611.76€ ashtu siç kërkohet me nenin 69 të LPP-se e sipas Rregullores për Prokurim Publik neni 25:

25.16 Në përputhje me nenin 69 të LPP-së, AK mund të kërkojë nga OE një listë të furnizimeve/shërbimeve/punëve të realizuara në 3 vitet e fundit. Kësaj liste duhet ti bashkëngjiten si dëshmi:

(i) kur furnizimi është bërë për një autoritet publik në Kosovë ose në një vend tjetër, për dëshmi të këtij livrimi shërben kopja e certifikatës (certifikata /raporti i përkohshëm i pranimit) të rëndësishme të lëshuar ose të bashkë-nënshkruara nga autoriteti i tillë. të gjitha këto dëshmi duhet të kenë vlerën e realizuar.

(ii) kur furnizimi është bërë për një blerës privat, për dëshmi të këtij livrimi shërben kopja e çdo dokumenti të nënshkruar nga blerësi dhe evidentimi i livrimit të tillë me dëshmi të pagesës nga banka;

Sipas LPP-se AK-ja gjatë procesit të vlerësimit duhet të bëjë sqarime në përputhje me nenin 59 dhe 72 të LPP-se se projekti i dorëzuar në Listën e kontratave “Alletta Sales Platform AG” të sqarohet se a është i përfunduar, pasi referenca e lëshuar në vitin 2024 që është bashkëngjitur në ofertë pika 4 tregon se është në zhvillim, përsosje të vazhdueshme, e tash në jemi në vitin 2025 dhe mundet që projekti është përfunduar tërësisht.

Ky lloj i shërbimeve për mendimin tim si ekspert mundet të jetë në përsosje në vazhdimësi varësisht nga garancioni që është kërkuar të aplikohet dhe për këtë arsye AK-ja ka mundur të kërkojë sqarime lidhur me pikën 4 pasi pagesat tregojnë se është përmbyllur projekti -referenca.

Në bazë të listës së referencave që ka ofruar kompania “Inspired Tech SH.P.K.” ankuese në bazë të LPP-se neni 69 dhe RRPP mundet të konsiderohet se ka plotësuar kushtin pasi ka listën e referencave e sa i përket referencave me Udhëzuesin nenin 10 duhet të kërkohen referencat.

AK për këtë aktivitet të prokurimit gjatë ekzaminimit vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve

nuk e ka bërë konform neni 59, 72 të LPP-së dhe njëkohësisht nuk e ka respektuar edhe neni 60 i LPP-së kriteri kryesor për dhënie të kontratës ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët.

Në bazë të kësaj si ekspert shqyrtues pretendimi ankimor është i bazuar.

Përgjigjja në pretendim 2

Sa i përket pretendimit se është shkelur neni 7 në bazë të raportit të vlerësimit si ekspert shqyrtues konstatoj se është bërë diskriminim ndaj OE “Inspired Tech SH.P.K.” ankues, gjithashtu OE ankues ka ofruar fakt/dëshminë se ku është diskriminuar si dhe që nuk është nën përputhje me nenin 6 dhe 7 të LPP-se. Autoriteti kontraktues ka përgjegjësi në bazë të neni 7 se gjatë procedurës së aktivitetit të prokurimit në asnjë mënyrë nuk guxon të redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë të një ose më shumë operatorëve ekonomik gjatë përpilimit të kriterëve të vlerësimit apo gjatë vlerësimit të ofertave.

Në bazë të kësaj si ekspert shqyrtues pretendimi ankimor është i bazuar.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli Shqyrtues pas shqyrtimit dhe analizimit të të gjithë dokumentacionit në platformën e e-prokurimit, pretendimeve ankimore, përgjigjeve të dhëna nga eksperti i çështjes i angazhuar nga OSHP, konsideron se raportet e ekspertizës i përmbajnë apriori elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilave dispozita kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë panelin dhe të gjitha palët me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore. Mirëpo duhet theksuar se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Paneli Shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjerë, duke e pasur parasysh natyrën e shkeljeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit. Prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, ndonjë raport dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjyqimit të pavarur dhe profesional të tij/sajë, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të LPP.

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik duhet të aprovohet si pjesërisht e bazuar. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur për të anuluar Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues për aktivitetin e prokurimit “Zhvillimi dhe avancimi i sistemit informativ të QKKTGJ” me nr. të prokurimit: 206-25-4780-2-1-1, ndërsa aktiviteti i prokurimit të kthehet në Rivlerësim për AK i cili obligohet të kërkoj sqarime shtesë me qëllim që të vërtetohet se projekti në fjalë a është përfunduar në tërësi, para publikimit të njoftimit për kontratë.

Bazuar në të lartcekurat, Paneli Shqyrtues konsideron se veprimet dhe aktet e AK, dhe vlerësimet e ekspertit shqyrtues lidhur plotësimin ose jo të kushteve të përshkruara si më sipër dhe pohimet ankimore në këtë rast përbëjnë bazë të mjaftueshme që aktivitetit i prokurimit të kthehet sërish në ri-vlerësim.

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Për pikën I të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 dhe 31 paragrafin të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën II të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 131 të LPP lidhur me nenin 29 paragrafin 3 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën IV të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 4 dhe paragrafin 6 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues
Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - MINISTRIA E SHËNDETËSISË**
- **OE - Inspired Tech SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: